

Aulon Shabani (1988-). Lektor pranë Departamentit të Elektroteknikës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike (<http://www.fie.upt.al/>), Universiteti Politeknik i Tiranës (<http://www.upt.al/>). Ka kryer shkollën tetë vjeçare (Adem Sheme, 2002) si dhe gjinazin (Hasan Tahsini, 2006) në Sarandë. Ka mbaruar studimet në vitin 2009 Bachelor në Inxhinieri Elektrike, Profili: Automatizim i Industrisë-Formues, duke vazhduar më tej me studimet Master i Shkencave në Inxhinieri Elektrike, Profili: Automatizim Industrie dhe përfunduar ato në vitin 2011.

Që nga diplomimi ka mbajtur postin e pedagogut në Departamentin e Elektroteknikës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, Universiteti Politeknik i Tiranës, ku në mësimdhënie kryesisht në bazat e inxhinierisë elektrike. Në vitin 2012 ka nisur dhe në vitin 2018 ka përfunduar studimet e Doktoratës duke mbrojtur disertacionin me temë “*Parashikimi i konsumit të energjisë në ndërtesat publike dhe rezidenciale duke aplikuar metodat e inteligjencës artificiale*” në Universitetin Politeknik të Tiranës. Gjatë kësaj periudhe ka përfitur i bursën EUROWEB+ për shkëmbim studentor në kuadër të studimeve doktorale nga periudha 01. 10. 2015 - 01. 04. 2017 (18 muaj) ku eksperiencia e përfitur në grupin e Sistemeve Inteligjente dhe Machine Learning e udhëhequr nga Prof. Dr. Eyke Hüllermeier në Universitetin Paderborn Gjermani ka qënë shumë me vlerë. Aktualisht është në mbyllje të procesit të fitimit të titullit akademik “Profesor i Asociuar” pranë Universitetit Politeknik të Tiranës.

Nga Tetor 2018 deri aktualisht (2024) ai është drejtuesi i Departamentit të Elektroteknikës.

Ka botuar gjerësisht në fushën e parashikimit të konsumit të energjisë duke përdorur qasjet e “Machine Learning” si pjesë e studimeve të doktoratës, si dhe pas përfundimit të doktoratës, ku puna kërkimore është bërë më intensive dhe gjithmonë në kërkim të rritjes së kontributit në fushën e përdorimit dhe optimizimit të konsumit të energjisë në ndërtesa. Një pjesë e kërkimit shkencor qëndron tek materialet elektro-përcjellëse kryesisht lëkura apo tekstile. Kjo përkon edhe me pjesëmarrjen si anëtar në disa grupe të ndryshme si: “Balkan Society of Textile Engineers”, NanoAlb group member “Nanotechnology in Textiles”. Anëtar në projekte të ndryshme si: CA20109 - Modular Energy Islands for Sustainability and Resilience (MODENERLANDS), CA16226 - Indoor living space improvement: Smart Habitat for the Elderly. (SHELD-ON), si dhe New Energy Curriculum Reform “NEST4WB Erasmus Project”. Gjithashtu ka qënë pjesë e komitetit organizativ të 2nd International Conference “Engineering and Entrepreneurship” 2019 organizuar në Tiranë, Shqipëri.

Ka prezantuar në konferenca ndërkombëtare në vende të BE kryesisht të organizuara nga organizata prestigjioze si IEEE, po ashtu ka një sërë publikimesh në revista të indeksuara me faktor impakti. Ai ka një profil në Google Scholar (<https://scholar.google.com/citations?user=txA75YMAAAAJ&hl=en>) në Scopus (<https://www.scopus.com/authid/detail.uri?authorId=57191918095>) si dhe ResearchGate (<https://www.researchgate.net/profile/Aulon-Shabani>).